

LIGJ
Nr. 58/2025

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “AFTËSIA RIPËRTËRITËSE
DHE ZHVILLIMI I GJELBËR – HUA E DYTË PËR POLITIKAT E ZHVILLIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e programit “Aftësia ripërtëritëse dhe zhvillimi i gjelbër – hua e dytë për politikatat e zhvillimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.10.2025.

Shpallur me dekretin nr. 392, datë 17.11.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

HUAJA NUMËR 97700 -AL

MARRËVESHJE HUAJE

**AFTËSIA RIPËRTËRITËSE DHE ZHVILLIMI I GJELBËR – HUA E DYTË PËR
POLITIKAT E ZHVILLIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje më datë, sipas datës së nënshkrimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”), për qëllimin e ofrimit të financimit për mbështetjen e Programit (sipas përcaktimit në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje). Banka ka vendosur të ofrojë këtë financim, ndër të tjera, bazuar në: i. veprimet e ndërmarra tashmë nga Huamarrësi, në kuadër të Programit, të cilat janë përshkruar në seksionin I [A] të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe ii. ruajtjen e kuadrit të përshtatshëm të politikave makroekonomike nga ana e Huamarrësit. Huamarrësi dhe Banka bien dakord, si më poshtë vijon:

Neni I

Kushte të përgjithshme; përkufizime

1.01. Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02. Me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat me shkronjë të madhe të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u caktohen atyre në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01. Banka pranon t'i japë hua Huamarrësit shumën prej njëqind e trembëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë eurosh (113,600,000 EURO), në vlerën që kjo shumë këmbehet herë pas here sipas Kursit të Këmbimit ("Huaja").

2.02. Tarifa Paraprake është një e katërta e një pikë përqindjeje (0,25%) e shumës së Huas.

2.03 Detyrimi i Angazhimit është një e katërta e një pikë përqindjeje (0,25%) në vit mbi Bilancin e Huas së Patërhequr.

2.04. Norma e interesit është Norma e Referencës plus Diferenca e Ndryshueshme ose norma që mund të zbatohet pas Këmbimit; sipas seksionit 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.05. Datat e pagesës janë 1 mars dhe 1 shtator të çdo viti.

2.06. Shuma e principalit të huas paguhet në përputhje me skedulin 3.03 të Kushteve të Përgjithshme dhe skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07. Pa u kufizuar nga dispozitat e seksionit 5.05 të Kushteve të Përgjithshme, Huamarrësi i siguron menjëherë Bankës informacionin që lidhet me dispozitat e këtij neni, sipas kërkesave të herëpashershme dhe të arsyeshme të Bankës.

Neni III

Programi

3.01. Huamarrësi deklaron angazhimin e vet ndaj Programit dhe zbatimit të tij. Për këtë qëllim dhe në kuadër të seksionit 5.05 të Kushteve të Përgjithshme:

a) Huamarrësi dhe Banka, herë pas here dhe me kërkesë të cilësdo palë, shkëmbejnë pikëpamjet lidhur me kuadrin e politikave makroekonomike të Huamarrësit dhe progresin e arritur në zbatimin e Programit;

b) përpara shkëmbimit të këtyre pikëpamjeve, Huamarrësi i vendos Bankës në dispozicion për shqyrtim dhe komente, një raport për progresin e arritur në zbatimin e Programit, i cili përfshin hollësitë e kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Banka; dhe

c) pa u kufizuar nga paragrafët (a) dhe (b) të këtij seksioni, Huamarrësi informon menjëherë Bankën lidhur me çdo situatë që mund të ketë ndikim material në zmbrapsjen e objektivave të Programit ose çdo veprimi të ndërmarrë në kuadër të Programit, duke përfshirë të gjitha veprimet e përcaktuara në seksionin 1 të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV

Mjetet ligjore të bankës

4.01. Rasti Shtesë i Pezullimit është specifikisht i lidhur me rastin kur është krijuar një situatë që do ta bëjë të pamundur zbatimin e Programit ose një pjesë të konsiderueshme të tij.

4.02. Rasti Shtesë i Përshpejtimit është specifikisht i lidhur me rastin kur ngjarja e përcaktuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje vërtetohet dhe vijon për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pasi Banka ka njoftuar Huamarrësin lidhur me të.

Neni V
Efektiviteti; përfundimi

5.01. Kushti Shtesë i Efektivitetit është specifikisht i lidhur me faktin që Banka është e bindur me progresin e arritur nga Huamarrësi në zbatimin e Programit dhe me përshtatshmërinë e kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

5.02. Afati i efektivitetit është data njëqind e njëzet (120) ditë pas datës së nënshkrimit.

Neni VI
Përfaqësimi; adresat

6.01. Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave.

6.02. Për qëllimet e seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) Adresa e Huamarrësit është:
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri; dhe

b) Adresa elektronike e Huamarrësit është:
E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

6.03. Për qëllimet e seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) Adresa e Bankës është si vijon:
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America (Shtetet e Bashkuara të Amerikës); dhe

a) Adresa elektronike e Bankës është:
Teleks: Faks: 248423(MCI) ose 1-202-477-6391
64145(MCI)

RËNË DAKORD në Datën e Nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga
Nënshkrimi

Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: PETRIT MALAJ
Funksioni: MINISTËR I FINANCIVE
Data: 19 Maj 2025

BANKA NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Nga

Nënshkrimi

Përfaqësuesi I Autorizuar

SKEDULI 1

Veprimet e Programit; Disponueshmëria e të Ardhurave të Huas

Seksioni I. Veprimet në kuadër të Programit

Veprimet e Ndërmarra në Kuadër të Programit Veprimet e ndërmarra nga Huamarrësi në kuadër të Programit, përfshijnë sa më poshtë:

Shtylla 1. Forcimi i aftësisë ripërtëritëse të sektorit qeveritar dhe familjeve

1. Me qëllim zgjerimin e bazës tatimore, Huamarrësi ka: a) miratuar aktet nënligjore në zbatim të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, për të paraqitur, ndër të tjera, listën e veprimtarive ekonomike që u nënshtrohen kërkesave të reja tatimore dhe ndryshimet në formularët e deklarimit dhe udhëzimet për plotësimin e formularëve të rinj, siç evidentohet në Udhëzimet e Përgjithshme nr. 26, datë 8 shtator 2023, dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 20 dhjetor 2023; dhe b) ka zgjeruar përkufizimin për veprimtarinë e biznesit të turizmit, duke përfshirë qiratë afatshkurtra, nëpërmjet ndryshimeve në Ligjin për Turizmin, siç evidentohet në ligjin nr. 30, datë 4 prill 2024.

2. Me qëllim rritja e monitorimin të rreziqeve të mundshme fiskale të natyrës jofinanciare të subjekteve me interes publik, Huamarrësi ka miratuar ndryshime në ligjin “Për auditimin”, për të prezantuar garantimin e qëndrueshmërisë, duke përfshirë ndër të tjera: a) rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e auditimit ligjor; b) garantimin që njësitë e mëdha dhe njësitë me interes publik do të auditohen vetëm nga firma auditimi dhe jo nga auditues individualë; c) forcimin e rolit dhe përgjegjësi të komisioneve të auditimit të njësisve me interes publik, siç evidentohet në ligjin nr. 126, dhjetor 2024.

3. Me qëllim mundësimin e përafrimit të politikave buxhetore me synimet për ndryshimet klimatike, Huamarrësi ka përfshirë në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) treguesit e performancës, lidhur me klimën, siç specifikohet në udhëzimin nr. 12 të Ministrit të Financave, datë 18 tetor 2024.

4. Me qëllim përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administrative të shërbimeve ekzistuese të kujdesit social, Huamarrësi: a) ka paraqitur mekanizma për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social në nivel NJQV-je/bashkie, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 2 tetor 2024; dhe b) ka miratuar metodologjinë mbi fondet për financimin e shërbimeve sociale nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 224, datë 9 prill 2024.

Shtylla 2. Forcimi i kuadrit për tregun e energjisë dhe përkallëzimi i energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë

5. Me qëllim zgjerimin dhe diversifikimin e furnizimit me energji të rinovueshme, Huamarrësi:

a) Ka vendosi operatorin e energjisë së rinovueshme dhe rregullat e tij të funksionimit, duke përfshirë ndër të tjera rolin e tij në lidhje me Kontratën për Diferencë, rregullat për çmimin e tregut bazuar për prodhuesit e rregulluar, rregullat për balancimin e palës përgjegjëse, siç dëshmohet me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 13 nëntor 2024;

b) miratoi masa për nxitjen dhe rregullimin e konsumatorëve dhe prodhuesve, që konsistojnë në: i. mbështetjen financiare të përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë në sektorët e ngrohjes dhe ftohjes për familjet, siç dëshmohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 733, datë 27 nëntor 2024; ii. rritja e investimeve private në prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e energjisë diellore dhe të erës, duke përfshirë, ndër të tjera, marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike që përfshijnë tarifën nxitëse, Kontratën për Diferencën, siç dëshmohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 13 nëntor 2024; dhe iii. rregullimin e kapacitetit të lejuar për instalimin e

energjisë elektrike për vetëprodhuesit dhe futjen e shlyerjeve financiare vjetore për vetëprodhuesit, siç dëshmohet nga udhëzimi nr. 8 i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 2 maj 2023.

6. Me qëllim nxitjen e Tregut të Organizuar të Shitjes me Shumicë, Huamarrësi ka lehtësuar rregullimin e tregut të tregtimit të energjisë nëpërmjet ALPEX-it, në dy faza për klientët e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm, siç përcaktohet në urdhrin nr. 50 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 7 prill 2023.

7. Me qëllim rritjen e eficiencës së energjisë në sektorin publik, Huamarrësi ka miratuar ligje që i udhëzojnë autoritetet kontraktuese të garantojnë zbatimin e standardeve të eficiencës së energjisë në të gjitha procedurat e prokurimit publik, nëpërmjet miratimit me vendimin nr. 498 të Këshillit të Ministrave, datë 1 gusht 2024.

Shtylla 3. Mbrojtja e mjedisit dhe reduktimi i gjurmës së karbonit.

8. Me qëllim reduktimin e degradimit mjedisor, Huamarrësi i ka dorëzuar Kuvendit Ligjin “Për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit”, për të përcaktuar se prodhuesit e rrjedhave të veçanta të mbetjeve janë përgjegjës për menaxhimin e atyre mbetjeve, siç evidentohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 802, 26 dhjetor 2024.

9. Me qëllim reduktimin e shkarkimeve të gazrave serë (GS), Huamarrësi ka miratuar ndryshime në ligjin “Për taksat kombëtare”, duke paraqitur rritje me faza të tatimit të karbonit për qymyrin, siç përcaktohet në ligjin nr. 96, “Për taksat kombëtare”, datë 7 dhjetor 2023.

10. Me qëllim pakësimin e shkarkimeve të gazrave të fluorifikuar serë (gazet F), Huamarrësi: a) ka krijuar sistem kuotash për importuesit/eksportuesit, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 13 nëntor 2024; b) ka vënë në zbatim dokumentacionin e licencimit për importuesit/eksportuesit, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 745, datë 4 dhjetor 2024; dhe c) ka vënë në zbatim kërkesat minimale për trajnimin dhe certifikimin e personave të përfshirë me gazet F, dhe regjistër importuesish/eksportuesish, siç parashikohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 13 nëntor 2024.

Seksioni II. Disponueshmëria e të Ardhurave të Huas

A. Të përgjithshme. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas sipas dispozitave të këtij seksioni dhe udhëzimeve të tjera shtesë që Banka mund të caktojë nëpërmjet njoftimeve drejtuar Huamarrësit.

B. Alokimi i Shumave të Huas. Huaja alokohet në: a) një kësht të vetëm tërheqjeje, nga i cili Huamarrësi mund të kryejë tërheqjen e të ardhurave të Huas; dhe b) shumat e kërkuara nga Huamarrësi për pagesën e: [A) Tarifës Paraprake; dhe B) çdo Kufi të Normës së Interesit ose Prim të Instrumentit Mbrojtës të Normës së Interesit]; Alokimi i shumave të Huas për këtë qëllim, përcaktohet në tabelën në vijim:

Alokimet	Shuma e Alokuar e Huas (shprehur në Euro)
1. Transhi i Vetëm i Tërheqjes	113,316,000
2. Tarifa Paraprake	284,000
3. Shuma për t’u paguar sipas seksionit 4.05 c) të Kushteve të Përgjithshme	0
SHUMA TOTALE	113,600,000

C. Kushtet e Lëshimit të Transhit të Tërheqjes

Nga Transhi i Vetëm i Tërheqjes nuk bëhet asnjë tërheqje, nëse Banka nuk është e bindur me: a) zbatimin e Programit nga Huamarrësi; dhe b) përshtatshmërinë e kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

D. Depozitimi i Shumave të Huas

Brenda tridhjetë (30) ditëve nga tërheqja e Huas nga Llogaria e Huas, Huamarrësi i raporton Bankës: a) shumën e saktë të përfituar në llogarinë e përmendur në seksionin 2.03 (a) të Kushteve të Përgjithshme; b) hollësitë e llogarisë në të cilën shuma e barasvlershme në Lekë e të Ardhurave të Huas do të depozitohet; c) vërtetimin që shuma e barasvlershme është përfshirë në sistemet e menaxhimit të buxhetit të Huamarrësit.

E. Data e Mbylljes. Data e Mbylljes është 31 dhjetor 2026.

SKEDULI 2

Planifikimi i Shlyerjes së Amortizimit të Lidhur me Angazhimin

Huamarrësi do të shlyejë shumën e principalit të huas, në përputhje me tabelën e mëposhtme, e cila përcakton datat e pagesës së Principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të Principalit të Huas për t'u paguar në çdo datë pagese të principalit ("Aksioni me këste").

Data e pagesës së principalit	Ndarje me këste
Në çdo datë 1 mars dhe 1 shtator Duke filluar nga data 1 mars 2030 deri më 1 mars 2042	3.85%
Më 1 shtator 2042	3.75%

SHTOJCA

Seksioni I. Përkufizimet

1. "ALPEX" është Bursa Shqiptare e Energjisë.
2. "Kontratë për Diferencë" është një marrëveshje ndërmjet një prodhuesi të energjisë elektrike me karbon të ulët dhe shoqërisë së kontratave me karbon të ulët, që i mundëson gjeneruesit të stabilizojë të ardhurat e tij në një nivel të rënë dakord paraprakisht për kohëzgjatjen e kontratës.
3. "Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 224" është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër "*Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror*", datë 9 prill 2024.
4. "Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 498" është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër "*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285 datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", datë 1 gusht 2024.
5. "Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 613" është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër "*Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018, 'Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social'*", datë 2 tetor 2024.
6. "Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 695" është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër "*Për miratimin e masave mbështetëse, rregullave dhe procedurave për përfitimin e masave mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme*", datë 13 nëntor 2024.
7. "Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 696" është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër "*Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësi të Operatorëve të Energjisë së Rinovueshme sh.p.k.*", datë 13 nëntor 2024.
8. "Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 707" është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër "*Për kushtet e veçanta, dokumentacionin shoqëruar, procedurën, afatet për dhënien e autorizimeve, si dhe mënyrën dhe kriteret për akordimin e kuotave vjetore. Importi i hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjet e mbushura paraprakisht me hidrofluorokarbone*", datë 13 nëntor 2024.

9. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 708” është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër *“Për përcaktimin e skemës së certifikimit dhe kërkesave për procesin e certifikimit për personat, që ushtrojnë veprimtarinë me pajisje që përmbajnë gaze të fluorifikuar me efekt serë”*, datë 13 nëntor 2024.

10. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 733” është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër *“Për miratimin e skemës së mbështetjes për arritjen e objektivit kombëtar për burimet e rinovueshme të energjisë në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes”*, datë 27 nëntor 2024.

11. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 745” është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër *“Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për subjektin e licencuar të sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitet në treg me gaze serë të fluorizuar dhe pajisje që përmbajnë këto gaze”*, datë 4 dhjetor 2024.

12. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 753” është vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër, datë 20 nëntor 2023, *“Për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 29/2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar”*.

13. “Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 802” do të thotë vendimi i Këshillit të Ministrave me të njëjtin numër, datë 26 dhjetor 2024, *“Mbi propozimin e projektligjit për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”*.

14. “Kushte të Përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimet e IBRD-së, Financimet e Politikave të Zhvillimit”, datë 14 dhjetor 2018 (rishikuar për herë të fundit më 15 korrik 2023), me ndryshimet e përcaktuara në seksionin II të kësaj shtojce.

15. “Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 26” është udhëzimi i Ministrisë së Financave me të njëjtin numër *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, datë 8 shtator 2023 dhe i botuar në Fletoren Zyrtare të Huamarrësit nr. 137, datë 20 shtator 2023.

16. Ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” është Ligji i Huamarrësit nr. 29, datë 30 mars 2023 dhe i botuar në Fletoren Zyrtare të Huamarrësit nr. 70, datë 2 maj 2023.

17. “Udhëzim nr. 8” nënkupton udhëzimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me të njëjtin numër, datë 2 maj 2023, *“Për një ndryshim në udhëzimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3, datë 20 qershor 2019, ‘Për miratimin e procedurës së thjeshtuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike diellore”*.

18. “Udhëzimi nr. 12” është udhëzimi i Ministrisë së Financave me të njëjtin numër, datë 18 tetor 2024 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 7 për procedurat standarde për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm”*.

19. “Ligji për turizmin” është ligji nr. 93/2015, i ndryshuar, i Huamarrësit.

20. “Ligji nr. 30” është ligji i Huamarrësit me të njëjtin numër *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 93/2015 për turizmin”*, datë 4 prill 2024, dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71/2024 të Huamarrësit.

21. “Ligji nr. 96” është ligji i Huamarrësit me të njëjtin numër *“Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.7.2008 për tatimet kombëtare”*, datë 7 dhjetor 2023 dhe i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187/2023 të Huamarrësit.

22. “Ligji nr. 126” nënkupton ligjin e Huamarrësit me të njëjtin numër *“Ligji i auditimit”*, datë 19 dhjetor 2024, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. /2025.

23. “Programi Buxhetor Afatmesëm” do të thotë kuadri buxhetor afatmesëm i Huamarrësit që mbulon vitin buxhetor të ardhshëm dhe dy vjetët fiskalë pasues, siç miratohet me vendime të Këshillit të Ministrave; “Programi Buxhetor Afatmesëm” do të thotë shumësi i tij.

24. “MIE” është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Huamarrësit dhe çdo institucion pasues i tij.

25. “MF” është Ministria e Financave e Huamarrësit dhe çdo institucion pasues i tij.

26. “Urdhri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 50” është urdhri i MIE-s së Huamarrësit me të njëjtin numër *“Për një ndryshim në urdhrin nr. 28, datë 18.1.2021, për miratimin e udhëzimeve për hapjen e tregut dhe rregullimin e çmimit të energjisë”*, datë 7 prill 2023.

27. “Tregu i Organizuar me Shumicë” është subjekti i Huamarrësit përgjegjës për menaxhimin dhe operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike nëpërmjet platformës elektronike të shitjes dhe platformës së shlyerjes financiare për tregjet e ditës në avancë dhe brenda ditës, përfshirë ankandet brenda ditës dhe shitjes së vazhdueshme ndërmjet anëtarëve të Bursës, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e përcaktuara në zbatim të vendimit 872/2022.

28. “Program” është programi i objektivave, politikave dhe veprimeve, i përcaktuar ose i përmendur në shkresën e datës 16 dhjetor 2024 të Huamarrësit drejtuar Bankës, ku deklarohet angazhimi i Huamarrësit për zbatimin e Programit dhe ku kërkohet asistencë nga Banka në mbështetje të Programit gjatë zbatimit të këtij të fundit, dhe që përmban veprimet e ndërmarra, përfshirë ato të përcaktuara në seksionin I të Planit të Punës 1 të kësaj Marrëveshjeje, dhe veprimet që do të ndërmerren në përputhje me objektivat e programit.

29. “Data e Nënshkrimit” është data e mëvonshme nga dy datat në të cilën Huamarrësi dhe Banka nënshkruajnë këtë Marrëveshje, dhe ky përkufizim gjen zbatim për të gjitha referencat ndaj “ata e Marrëveshjes së Huas” në Kushtet e Përgjithshme.

30. “Transh i Vetëm i Tërheqjes” është shuma e Huas e alokuar për kategorinë e emërtuar “Transh i Vetëm i Tërheqjes” në tabelën e përcaktuar në pjesën B të seksionit II të Planit të Punës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni II. Ndryshimet e Kushteve të Përgjithshme

Kushtet e Përgjithshme janë ndryshuar me tekstin e mëposhtëm:

1. Seksioni 3.01 (*Tarifa Paraprake; Detyrimi i Angazhimit; Tarifa e Ekspozimit*) është ndryshuar me tekstin e mëposhtëm:

“Seksioni 3.01. *Tarifa Paraprake; Detyrimi i Angazhimit*

a) Huamarrësi i paguan Bankës një Tarifë Paraprake për shumën e Huas në normën e përcaktuar në Marrëveshjen e Huas. Përveç kur parashikohet ndryshe në seksionin 2.05 (b), Huamarrësi e paguan Tarifën Paraprake jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas Datës së Hyrjes në Fuqi.

b) Huamarrësi i paguan Bankës një Detyrim Angazhimi për Bilancin e Huas së Patërhequr në normën e përcaktuar në Marrëveshjen e Huas. Detyrimi i Angazhimit mbledhet nga gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së Marrëveshjes së Huas deri në datat kur shumat tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Huas, ose anulohen. Përveç kur parashikohet ndryshe në seksionin 2.05 (c), Huamarrësi e paguan Detyrimin e Angazhimit çdo gjashtë muaj me pagesat e prapambetura në secilën Datë Pagese”.

2. Seksioni 3.04 (*Parapagimi*) është ndryshuar me tekstin e mëposhtëm:

“Seksioni 3.04. *Parapagimi*

a) Pasi i ka dhënë Bankës njoftim prej jo më pak se dyzet e pesë ditë para (45), Huamarrësi mund t’i shlyejë Bankës shumat e mëposhtme përpara maturimit, deri në një datë të pranueshme për Bankën (me kusht që Banka të ketë kryer të gjitha Pagesat e Huas të kërkuara deri në atë datë): i. Bilancin e plotë të Huas së Patërhequr deri në atë datë; ose ii. shumën e plotë të principalit për një ose më shumë nga maturimet e Huas. Çdo parapagim i pjesshëm i Bilancit të Huas së Patërhequr zbatohet në mënyrën e përcaktuar nga Huamarrësi, ose në mungesë të përcaktimit nga Huamarrësi, në mënyrën e mëposhtme: A) Nëse Marrëveshja e Huas parashikon amortizim të veçantë të Shumave të Disbursuara të përcaktuara të principalit të Huas, parapagimi zbatohet në rend të anasjelltë të këtyre Shumave të Disbursuara, ku Shuma e Disbursuar e tërhequr në fund, shlyhet e para dhe ku maturimi i fundit i asaj Shume të Disbursuar shlyhet i pari; dhe B) në të gjitha rastet e tjera, parapagimi zbatohet në rend të anasjelltë të maturimeve të Huas, ku maturimi i fundit shlyhet i pari.

b) Nëse, në lidhje me ndonjë shumë të Huas për t’u shlyer, Këmbimi ka hyrë në fuqi dhe Periudha e Këmbimit nuk ka përfunduar në kohën e parapagimit, zbatohen dispozitat e Seksionit 4.06.”

3. Në paragrafët e numërtuar fillimisht 73 dhe 79 të Shtojcës, termat “Pagesa e Huas” dhe “Data e Pagesës” janë modifikuar përkatësisht me tekstin e mëposhtëm:

“73. “Pagesë Huaje” nënkupton çdo shumë që i paguhet Bankës nga Palët e Huas, në përputhje me Marrëveshjet Ligjore, duke përfshirë (por pa u kufizuar në) çdo shumë të Bilancit të Huas së

Patërhequr, interesin, Tarifën Paraprake, Detyrimin e Angazhimit, interesin për Normën e Interesit të Papaguar (nëse ka), tarifën, tarifën e transaksionit për Këmbim ose përfundimin e hershëm të Këmbimit, primin e pagueshëm me krijimin e Kufirit të Normës së Interesit ose Instrumentit Mbrojtës të Normës së Interesit, dhe Shumën Përmbyllëse që paguhet nga Huamarrësi.

79. “Datë Pagese” nënkupton çdo datë të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas, që bie më ose pas datës së Marrëveshjes Huas, në të cilën interesi, Detyrimi i Angazhimit dhe detyrimet dhe tarifat e tjera të Huas (të ndryshme nga Tarifa Paraprake) bëhen të pagueshme, sipas rastit.”

4. Përkufizimet në paragrafët 4 (Shuma e Tepërt e Alokuar për Ekspozimin); 51 (Tarifa-Shtesë e Ekspozimit); 93 (Kufiri Standard i Ekspozimit) dhe 99 (Ekspozimi Total) në shtojcë janë fshirë që të gjitha në tërësinë e tyre dhe përkufizimet dhe paragrafët e mbetur (sipas rastit) rinumërtohen sipas rrethanave.

Loan Agreement

**(Second Resilience and Green Development -
Development Policy Loan)**

between

ALBANIA

and

**INTERNATIONAL BANK FOR RECONSTRUCTION
AND DEVELOPMENT**

LOAN AGREEMENT

AGREEMENT dated as of the Signature Date between ALBANIA ("Borrower") and INTERNATIONAL BANK FOR RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT ("Bank") for the purpose of providing financing in support of the Program (as defined in the Appendix to this Agreement). The Bank has decided to provide this financing on the basis, inter alia, of: (i) the actions which the Borrower has already taken under the Program and which are described in Section I of Schedule 1 to this Agreement; and (ii) the Borrower's maintenance of an adequate macroeconomic policy framework. The Borrower and the Bank therefore hereby agree as follows:

ARTICLE I — GENERAL CONDITIONS; DEFINITIONS

- 1.01. The General Conditions (as defined in the Appendix to this Agreement) apply to and form part of this Agreement.
- 1.02. Unless the context requires otherwise, the capitalized terms used in this Agreement have the meanings ascribed to them in the General Conditions or in the Appendix to this Agreement.

ARTICLE II — LOAN

- 2.01. The Bank agrees to lend to the Borrower the amount of Euro one hundred thirteen million six hundred thousand (EUR113,600,000), as such amount may be converted from time to time through a Currency Conversion ("Loan").
- 2.02. The Front-end Fee is one quarter of one percent (0.25%) of the Loan amount.
- 2.03. The Commitment Charge is one quarter of one percent (0.25%) per annum on the Unwithdrawn Loan Balance.
- 2.04. The interest rate is the Reference Rate plus the Variable Spread or such rate as may apply following a Conversion; subject to Section 3.02(e) of the General Conditions.
- 2.05. The Payment Dates are March 1 and September 1 in each year.
- 2.06. The principal amount of the Loan shall be repaid in accordance with Section 3.03 of the General Conditions and Schedule 2 to this Agreement.
- 2.07. Without limitation upon the provisions of Section 5.05 of the General Conditions, the Borrower shall promptly furnish to the Bank such information relating to the provisions of this Article II as the Bank may, from time to time, reasonably request.

ARTICLE III — PROGRAM

- 3.01. The Borrower declares its commitment to the Program and its implementation. To this end, and further to Section 5.05 of the General Conditions:
- (a) the Borrower and the Bank shall from time to time, at the request of either party, exchange views on the Borrower's macroeconomic policy framework and the progress achieved in carrying out the Program;
 - (b) prior to each such exchange of views, the Borrower shall furnish to the Bank for its review and comment a report on the progress achieved in carrying out the Program, in such detail as the Bank shall reasonably request; and
 - (c) without limitation upon paragraph (a) and (b) of this Section, the Borrower shall promptly inform the Bank of any situation that would have the effect of materially reversing the objectives of the Program or any action taken under the Program including any action specified in Section I of Schedule 1 to this Agreement.

ARTICLE IV — REMEDIES OF THE BANK

- 4.01. The Additional Event of Suspension consists of the following, namely that a situation has arisen which shall make it improbable that the Program, or a significant part of it, will be carried out.
- 4.02. The Additional Event of Acceleration consists of the following, namely that the event specified in Section 4.01 of this Agreement occurs and is continuing for a period of sixty (60) days after notice of the event has been given by the Bank to the Borrower.

ARTICLE V — EFFECTIVENESS; TERMINATION

- 5.01. The Additional Condition of Effectiveness consists of the following, namely that the Bank is satisfied with the progress achieved by the Borrower in carrying out the Program and with the adequacy of the Borrower's macroeconomic policy framework.
- 5.02. The Effectiveness Deadline is the date one hundred and twenty (120) days after the Signature Date.

ARTICLE VI — REPRESENTATIVE; ADDRESSES

- 6.01. The Borrower's Representative is its Minister of Finance.

6.02. For purposes of Section 10.01 of the General Conditions:

(a) the Borrower's address is:

Ministry of Finance
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Albania; and

(b) the Borrower's Electronic Address is:

E-mail:

sekretariamin@financa.gov.al

6.03. For purposes of Section 10.01 of the General Conditions:

(a) the Bank's address is:

International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America; and

(b) the Bank's Electronic Address is:

Telex:

Facsimile:

248423(MCI) or
64145(MCI)

1-202-477-6391

AGREED as of the Signature Date.

ALBANIA

By


Authorized Representative

Name: PETRIT MALAJ

Title: MINISTER OF FINANCE

Date: MAY 18, 2025

INTERNATIONAL BANK FOR
RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT

By


Authorized Representative

Name: Xiaoping Yu

Title: Division Director, Western Balkans

Date: April 16, 2025

SCHEDULE 1

Program Actions; Availability of Loan Proceeds

Section I. Actions under the Program

Actions Taken Under the Program. The actions taken by the Borrower under the Program include the following:

Pillar 1. Strengthen resilience of the government sector and households

1. To broaden the tax base, the Borrower has: (a) adopted secondary legislation to implement the Income Tax Law to introduce, *inter alia*, the list of economic activities subject to the new tax requirements, and changes to the declaration forms, as evidenced by General Instructions No. 26 dated September 8, 2023, and the Decision of Council of Ministers No. 753, dated December 20, 2023; and (b) expanded the definition of tourism business activity to include short term rentals, through amendments to the Law for Tourism, as evidenced by Law No. 30 dated April 4, 2024.
2. To enhance the monitoring of potential fiscal risks of a non-financial nature from public interest entities, the Borrower has enacted amendments to the Audit Law to introduce sustainability assurance including, *inter alia* (a) increasing the transparency and accountability in the statutory audit process; (b) reinforcing ethical requirements for auditors and enhancing quality assurance system for audits and auditors; and (c) strengthening the role and responsibilities of audit committees of public interest entities, as evidenced through Law No.126 dated December 19, 2024.
3. To enable alignment of budget policies with climate change goals, the Borrower has required the introduction of climate-related performance indicators in the Medium-Term Budget Program, as evidenced by a Minister of Finance's Instruction No. 12 dated October 18, 2024.
4. To improve funding stability and accountability of, and enhance access to, social care services, the Borrower has: (a) introduced mechanisms for the establishment and functioning of the Social Fund at the local government units level, through Decision of Council of Ministers No. 613 dated October 2, 2024; and (b) approved the methodology on funds for financing of social services through Decision of Council of Ministers No. 224 dated April 9, 2024.

Pillar 2. Strengthen the energy market framework and scale up renewable energy and energy efficiency

5. To expand and diversify the supply of renewable energy, the Borrower has:
 - (a) established the renewable energy operator and its rules of operation including *inter alia* its role with respect to Contract for Difference, the rules for pricing the market based for the regulated producers, rules for balancing responsible party, as evidenced by Decision of the Council of Ministers No. 696 dated November 13, 2024;
 - (b) adopted measures to promote and regulate consumers and producers consisting of: (i) financial support use of renewable energy sources in the heating and cooling sectors for the households, as evidenced by Decision of the Council of Ministers No. 733 dated November 27, 2024; (ii) increased private investment in the production of electricity from solar and wind energy sources, including *inter alia*, power purchase agreements that include feed-in tariffs, Contract for Difference, as evidenced by the Decision of the Council of Ministers No. 695 dated November 13, 2024; and (iii) regulating the allowed capacity for installation of electricity for self-producers and introducing the annual financial settlements for the self-producers, as evidenced by Ministry of Infrastructure and Energy Instruction No. 8 dated May 2, 2023.
6. To promote the Organized Wholesale Market, the Borrower has further deregulated energy market trading, through ALPEX, in two-phases for high-voltage and medium-voltage clients, as evidenced by Ministry of Infrastructure and Energy Order No. 50 dated April 7, 2023.
7. To increase energy efficiency in the public sector, the Borrower has required contracting authorities to ensure application of energy efficiency standards in all public procurement procedures, through approval by the Decision of the Council of Ministers No. 498 dated August 1, 2024.

Pillar 3. Protect the environment and reduce the country's carbon footprint

8. To reduce environmental degradation, the Borrower has submitted to Parliament, the Law on Extended Producer Responsibility to mandate that producers of specific waste streams are responsible for management of that waste, as evidenced through Decision of Council of Ministers No.802 dated December 26, 2024.

9. To reduce Green House Gas (GHG) emissions, the Borrower has enacted amendments to the Law on National Taxes to introduce a phased increase in its carbon tax on coal, as evidenced by the Law No. 96 dated December 7, 2023.
10. To reduce emissions of fluorinated greenhouse gases (F-gases), the Borrower has: (a) established a quota system for importers, as evidenced by the Decision of Council of Ministers No. 708 dated November 13, 2024; (b) introduced licensing documentation for importers/exporters, as evidenced by Decision of Council of Ministers No. 745 dated December 4, 2024; and (c) introduced minimum requirements for training and certification of persons involved with F-gases, and a registry of importers/exporters, as evidenced by Decision of Council of Ministers No. 707 dated November 13, 2024.

Section II. Availability of Loan Proceeds

- A. General.** The Borrower may withdraw the proceeds of the Loan in accordance with the provisions of this Section and such additional instructions as the Bank may specify by notice to the Borrower.
- B. Allocation of Loan Amounts.** The Loan is allocated in: (a) a single withdrawal tranche, from which the Borrower may make withdrawals of the Loan proceeds; and (b) the amounts requested by the Borrower to pay: (A) the Front-end Fee and (B) each Interest Rate Cap or Interest Rate Collar premium. The allocation of the amounts of the Loan to this end is set out in the table below:

Allocations	Amount of the Loan Allocated (expressed in EUR)
(1) Single Withdrawal Tranche	113,316,000
(2) Front-end Fee	284,000
(3) Amount due pursuant to Section 4.05 (c) of the General Conditions	0
TOTAL AMOUNT	113,600,000

C. Withdrawal Tranche Release Conditions.

No withdrawal shall be made of the Single Withdrawal Tranche unless the Bank is satisfied: (a) with the Program being carried out by the Borrower; and (b) with the adequacy of the Borrower's macroeconomic policy framework.

D. Deposit of Loan Amounts.

The Borrower, within thirty (30) days after the withdrawal of the Loan from the Loan Account, shall report to the Bank: (a) the exact sum received into the account referred to in Section 2.03 (a) of the General Conditions; (b) the details of the account to which the Albanian Lek equivalent of the Loan proceeds will be credited; and (c) the record that an equivalent amount has been accounted for in the Borrower's budget management systems.

E. Closing Date. The Closing Date is December 31, 2026.

SCHEDULE 2

Commitment-Linked Amortization Repayment Schedule

The Borrower shall repay the principal amount of the Loan in accordance with the following table, which sets forth the Principal Payment Dates of the Loan and the percentage of the total principal amount of the Loan payable on each Principal Payment Date ("Installment Share").

Level Principal Repayments

Principal Payment Date	Installment Share
On each March 1 and September 1 Beginning March 1, 2030 through March 1, 2042	3.85%
On September 1, 2042	3.75%

APPENDIX

Section I. Definitions

1. “ALPEX” means Albanian Power Exchange.
2. “Contract for Difference” means an agreement between a low carbon electricity generator and the low carbon contracts company that enables the generator to stabilize its revenues at a pre-agreed level for the duration of the contract.
3. “Decision of Council of Ministers No. 224” means the Council of Ministers’ decision of the same number “*On the Methodology of Calculating Funds for the Financing of Social Care Services*” dated April 9, 2024.
4. “Decision of the Council of Ministers No. 498” means the Council of Ministers’ decision of the same number “*For Some Additions and Changes in Decision No. 285 dated 19.5.2021 of the Council of Ministers for the Approval of Public Procurement Rules*” dated August 1, 2024
5. “Decision of Council of Ministers No. 613” means the Council of Ministers’ decision of the same number “*On Some Changes to the Decision of the Council of Ministers No. 111 dated 23.2.2018 "On the Establishment and Functioning of the Social Fund"*” dated October 2, 2024.
6. “Decision of the Council of Ministers No. 695” means the Council of Ministers’ decision of the same number “*On Adopting Support Measures, Rules and Procedures for the Benefit of Support Measures for the Production of Electricity from Renewable Sources*” dated November 13, 2024.
7. “Decision of the Council of Ministers No. 696” means the Council of Ministers’ decision of the same number “*For the Determination of Duties and Responsibilities of Renewable Energy Operators LLC*” dated November 13, 2024.
8. “Decision of Council of Ministers No. 707” means the Council of Ministers’ decision of the same number “*On Special Conditions, Show Documentation, Deadline procedures for Granting Authorization, as well as for the Method and the Criteria for Allocating Quotas Annual Import of Hydrofluorocarbons and/or devices prefilled with Hydrofluorocarbons*” dated November 13, 2024.
9. “Decision of Council of Ministers No. 708” means the Council of Ministers’ decision of the same number “*On Determination of the Certification Scheme and the Requirements for the Certification Process to the Persons Exercise Activity with devices that Contain Fluorinated Greenhouse Gases*” dated November 13, 2024.

10. “Decision of Council of Ministers No. 733” means the Council of Ministers’ decision of the same number *“On the adoption of support scheme for achieving the national target. for renewable energy sources in the heating and cooling sector”* dated November 27, 2024.
11. “Decision of Council of Ministers No. 745” means the Council of Ministers’ decision of the same number *“On determining the necessary documentation for the license entity of entrepreneurs operating on the market with fluorinated greenhouse gases and equipment containing these gases”* dated December 4, 2024.
12. “Decision of Council of Ministers No. 753” means the Council of Ministers’ decision of the same number dated December 20, 2023 *“For the Implementation of Provisions of Law no. 29/2023 “On Income Tax”, as amended”*.
13. Decision of Council of Ministers No. 802” means the Council of Ministers’ decision of the same number dated December 26, 2024 *“About the Proposal of the Draft Law on Extended Responsibilities of Producing Entities of Products that Generate Waste”*.
14. “General Conditions” means the “International Bank for Reconstruction and Development General Conditions for IBRD Financing, Development Policy Financing”, dated December 14, 2018 (Last revised on July 15, 2023), with the modifications set forth in Section II of this Appendix.
15. “General Instructions No. 26” means the Ministry of Finance’s instructions of the same number *“On Income Tax”* dated September 8, 2023 and published in the Borrower’s Official Gazette No.137 dated September 20, 2023.
16. “Income Tax Law” means the Borrower’s Law No. 29 dated March 30, 2023 and published in the Borrower’s Official Gazette No.70 dated May 2, 2023.
17. “Instruction No. 8” means the Ministry of Infrastructure and Energy’s instruction of the same number dated May 2, 2023 *“On a change in the instruction of the Minister of Infrastructure and Energy no.3, dated 20 June 2019, “for the approval of the simplified authorization procedure for connection to the distribution system of small renewable projects for self-producers of solar electricity”*.
18. “Instruction No. 12” means the Ministry of Finance’s instructions of the same number dated October 18, 2024 *“For Some Additions and Changes to Instructions No.7 for Standard Procedures for the Preparation of the Medium-Term Budget Program”*.
19. “Law for Tourism” means the Borrower’s Law No. 93/2015, as amended.

20. “Law No. 30” means the Borrower law of the same number “*For Some Changes and Additions to Law No. 93/2015 for Tourism*” dated April 4, 2024 and published in the Borrower’s Official Gazette No. 71/2024.
21. “Law No. 96” means the Borrower’s law of the same number “*On Some Changes to the Law No. 9975 dated 28.07.2008 on National Taxes*” dated December 7, 2023 and published in the Borrower’s Official Gazette No. 187/2023.
22. “Law No.126” means the Borrower’s law of the same number “*Audit Law*” dated December 19, 2024 published in the Borrower’s Official Gazette No. __/2025.
23. “Medium-Term Budget Program” means the Borrower’s medium-term budget framework covering the next budget year and the following two fiscal years as approved through decisions of the Council of Ministers; “Medium-Term Budget Programs” means the plural thereof.
24. “MoIE” means the Borrower’s ministry of infrastructure and energy, or any successor thereto.
25. “MoF” means the Borrower’s ministry of finance, or any successor thereto.
26. “Order No. 50” means the Borrower’s MoIE’s order of the same number “*On a Change of Order No.28 dated 18.01.2021 for the Approval of the Guidelines for Opening the Market and Regulating the Price of Electricity*” dated April 7, 2023.
27. “Organized Wholesale Market” means the Borrower’s entity responsible for the management and operation of the organized electricity wholesale market via the electronic trading platform, the electronic clearing and financial settlement platform for the day-ahead and intraday markets, including intraday auctions and continuous trading between Exchange members, in accordance with the electricity market model and rules set forth pursuant to Decision 872/2022.
28. “Program” means: the program of objectives, policies, and actions set forth or referred to in the letter dated December 16, 2024 from the Borrower to the Bank declaring the Borrower’s commitment to the execution of the Program, and requesting assistance from the Bank in support of the Program during its execution and comprising actions taken, including those set forth in Section I of Schedule 1 to this Agreement, and actions to be taken consistent with the program’s objectives.
29. “Signature Date” means the later of the two dates on which the Borrower and the Bank signed this Agreement and such definition applies to all references to “the date of the Loan Agreement” in the General Conditions.

30. "Single Withdrawal Tranche" means the amount of the Loan allocated to the category entitled "Single Withdrawal Tranche" in the table set forth in Part B of Section II of Schedule 1 to this Agreement.

Section II. Modifications to the General Conditions

The General Conditions are hereby modified as follows:

1. Section 3.01 (*Front-end Fee; Commitment Charge; Exposure Surcharge*) is modified to read as follows:

"Section 3.01. *Front-end Fee; Commitment Charge*

(a) The Borrower shall pay the Bank a Front-end Fee on the Loan amount at the rate specified in the Loan Agreement. Except as otherwise provided in Section 2.05 (b), the Borrower shall pay the Front-end Fee not later than sixty (60) days after the Effective Date.

(b) The Borrower shall pay the Bank a Commitment Charge on the Unwithdrawn Loan Balance at the rate specified in the Loan Agreement. The Commitment Charge shall accrue from a date sixty (60) days after the date of the Loan Agreement to the respective dates on which amounts are withdrawn by the Borrower from the Loan Account or cancelled. Except as otherwise provided in Section 2.05 (c), the Borrower shall pay the Commitment Charge semi-annually in arrears on each Payment Date."

2. Section 3.04 (*Prepayment*) is modified to read as follows:

"Section 3.04. *Prepayment*

(a) After giving not less than forty-five (45) days' notice to the Bank, the Borrower may repay the Bank the following amounts in advance of maturity, as of a date acceptable to the Bank (provided that the Borrower has paid all Loan Payments due as at such date): (i) the entire Withdrawn Loan Balance as at such date; or (ii) the entire principal amount of any one or more maturities of the Loan. Any partial prepayment of the Withdrawn Loan Balance shall be applied in the manner specified by the Borrower, or in the absence of any specification by the Borrower, in the following manner: (A) if the Loan Agreement provides for the separate amortization of specified Disbursed Amounts of the principal of the Loan the prepayment shall be applied in the inverse order of such Disbursed Amounts, with the Disbursed Amount which has been withdrawn last being repaid first and with the latest maturity of said Disbursed Amount being repaid first; and (B) in all other cases, the prepayment shall be applied in the inverse order of the Loan maturities, with the latest maturity being repaid first.

(b) If, in respect of any amount of the Loan to be prepaid, a Conversion has been effected and the Conversion Period has not terminated at the time of prepayment, the provisions of Section 4.06 shall apply.”

3. In paragraphs originally numbered 73, and 79 of the Appendix, the terms “Loan Payment” and “Payment Date”, respectively are modified to read as follows:

73. “Loan Payment” means any amount payable by the Loan Parties to the Bank pursuant to the Legal Agreements, including (but not limited to) any amount of the Withdrawn Loan Balance, interest, the Front-end Fee, the Commitment Charge, interest at the Default Interest Rate (if any), any surcharge, any transaction fee for a Conversion or early termination of a Conversion, any premium payable upon the establishment of an Interest Rate Cap or Interest Rate Collar, and any Unwinding Amount payable by the Borrower.

“79. “Payment Date” means each date specified in the Loan Agreement occurring on or after the date of the Loan Agreement on which interest, Commitment Charge and other Loan charges and fees (other than the Front-end Fee) are payable, as applicable.”

4. The definitions in paragraphs 4 (Allocated Excess Exposure Amount); 51 (Exposure Surcharge); 93 (Standard Exposure Limit) and 99 (Total Exposure) in the Appendix are all deleted in their entirety and the remaining definitions and paragraphs (as the case may be) renumbered accordingly.